

Instituti për Studime të Avancuara GAP

## Letërnjoftimi i Komunës së Drenasit 2012

Nëntor, 2012

*“Letërnjoftimi i Komunave”* është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive .....	3
1. Hyrje .....	5
2. Problemet në Komunën e Drenasit .....	5
3. Performanca buxhetore e Komunës së Drenasit .....	7
4. Investimet kapitale .....	11
5. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2011 .....	14
6. Administrata e Komunës së Drenasit .....	15
7. Arsimi në Komunën e Drenasit .....	16
8. Shëndetësia në Komunën e Drenasit .....	19
9. Transparenca .....	20
10. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009 .....	22
11. Burimet:.....	24

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Drenasit që nga pas lufta qeveriset nga Partia Demokratike e Kosovës. Në këtë komunë, ekziston gjendje jo e mirë ekologjike dhe ekonomike. Niveli i ndotjes i shkaktuar nga fabrika e Ferronikelit vazhdon të shkaktojë probleme shëndetësore për qytetarët e kësaj komune. Të dhënat zyrtare flasin se vetëm gjatë vitit 2011, mbi 20.000 qytetarë të kësaj komune kanë kërkuar ndihmën e mjekut, shumica për shkak të vështirësive me frymëmarrjen. Kjo është një shifër e madhe krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullatës prej 58.000 banorësh. Edhe rastet e paraqitura me sëmundje kanceroze kanë shënuar rritje, ku 15 raste janë evidentuar në Drenas gjatë vitit 2011, përderisa dy vite me herët numri ka qenë deri në tetë raste gjatë një viti. Megjithatë, nuk mund të vërtetohet nëse të gjitha rastet e sëmundjeve me kancer kanë ardhur si pasojë e ndotjes nga Feronikeli. Për më tepër, kjo fabrikë ka ulur dukshëm nivelin e ndotjes kohëve të fundit. Deri në vitin e kaluar, 2011, kjo fabrikë ka shkaktuar ndotje enorme të ambientit, por shpërthimet që ndodhën në atë vit u pasuan me një presion nga ana e Qeverisë, institucioneve lokale dhe medieve që kjo ndërmarrje ta përmirësojë gjendjen ambientale dhe sigurinë në punë. Nga tetori i vitit të kaluar, Feronikeli ka nisur t'i vendos filtrat si dhe ka vënë në funksion sistemin kontinual të matjes së gazrave i cili përcjelllet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Progresi i lehtë i vërejtur në Komunën e Drenasit në rritjen e shkallës së të hyrave komunale është shoqëruar me rritjen e shpenzimeve në kategorinë e darkave dhe drekave zyrtare, shpenzimeve për telefona, mëditjeve, udhëtimeve, karburanteve si dhe në linjat tjera të përafërta. Po ashtu, në këtë komunë gjatë këtyre tri viteve të fundit janë hasur raste të shpërfilljes së rregullave ligjore, nepotizëm, konflikt interesi gjatë dhënies së tenderëve për kryerjen e punëve publike, cilësi e ulët e punimeve gjatë investimeve në infrastrukturë si dhe fshehje të obligimeve të pashlyera financiare.

Komuna e Drenasit vetëm në vitin e fundit, 2011, për telefona, dreka dhe darka zyrtare si dhe karburant për vetura ka shpenzuar mbi 121.000 euro. Nga të dhënat rezulton së Komuna e Drenasit ka shpenzuar më shumë së Komuna e Malishevës, Lipjanit dhe Vitisë në dreka dhe darka zyrtare, si dhe në telefona mobil dhe fiks.

Në katër vitet e fundit, Komuna e Drenasit vetëm për dreka dhe darka zyrtare ka shpenzuar mbi 139.580 euro. Viti i zgjedhjeve lokale në vend (2009) është karakterizuar me shifrën më të madhe të shpenzimit të parasë publike për këtë kategori, përkatësisht gjatë atij vitit rezultojnë të shpenzuara 62.860 euro.

Ndërsa në nëntë mujorin e parë të këtij viti, për mirëmbajtjen e objekteve, riparimin e veturave, marketing, lëndë djegëse dhe dreka zyrtare janë shpenzuar nga Komuna e Drenasit mbi 216.000 euro.

Krahasimi i shifrave që Komuna e Drenasit dedikon në mallëra dhe shërbime me komunat e përfaqësuara për nga numri i banorëve si Lipjani, Malisheva, Rahoveci, Skenderaj, nxjerr në pah se Drenasi ka shumëfish më shumë buxhet në këtë kategori se komunat tjera, ndonëse këto të fundit shkallën e të hyrave komunale e kanë më të lartë se Drenasi. Nga linja e buxhetit për mallëra dhe shërbime kryhen pagesat për derivate dhe lëndë djegëse, darka dhe dreka zyrtare, udhëtime, mëditje, ushqim, shpenzime telefonike, mirëmbajtje të objekteve dhe veturave, blerje të mobileve dhe pajisjeve të tjera si dhe pagesat eventuale për qiramarrje.

Disa zyrtarë të kësaj Komune kanë lënë punën për shkak se i kanë konsideruar disa veprime të Komunës si jo ligjore. Kësisoj, ish Drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Liman Krasniqi, ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij si drejtor në gjysmën e dytë të vitit 2009 me arsyetimin zyrtar se nuk dëshiron të bëhet shkelës i ligjit duke dhënë leje ndërtimi pa kriter.

Kryetari i Komunës favorizon të afërmit e tij për të blerë derivatet djegëse për nevojat e Komunës dhe po ashtu për punët tjera me rëndësi publike.

Një dukuri që e ka përcjellë në vazhdimësi sistemin arsimor në Komunën e Drenasit është punësimi i stafit mbi baza familjare. Administrata komunale përbëhet kryesisht nga meshkujt. Nga 162 të punësuar në komunë, vetëm 28 janë femra. Po ashtu niveli i arsimimit të të punësuarve në administratë është kryesisht me shkollë të mesme.

Problematikë në investimet kapitale në këtë komunë, mbetet cilësia e dobët e punimeve dhe mos saktësimi më kohë i rrjedhës së investimeve. Ka pasur disa raste kur njëherë është shtruar rruga dhe pas një kohë autoritetet janë detyruar ta prishin rrugën me qëllim të instalimit të rrjetit të kanalizimit apo ujësjellësit. Kjo ka ngjarë disa herë në zonat urbane të qytetit. Mos saktësimi i plotë i investimeve ka ngjarë edhe me sheshin "Fehmi Lladrovci." Ky shesh i rregulluar në qendër të qytetit brenda tri viteve është ristrukturuar e riparuar katër herë radhazi nga kompani të ndryshme dhe me kosto të ndryshme.

Kryetari i Komunës është treguar i matur gjatë dhënies së premtimeve në fushatën zgjedhore 2009. Premtimet e dhëna prej tij janë lidhur kryesisht me infrastrukturën, premtime që rezultojnë kryesisht të përmbushura.

## 1. Hyrje

Komuna e Drenasit e cila shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, që nga pas lufta qeveriset nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Kryetar i parë i kësaj komune ka qenë Izet Ibrahim (2000-2002) i pasuar nga Gani Sylaj (2003-2005), pastaj Sherif Krasniqi i cili ka udhëhequr deri në vitin 2007, vit ky kur në vend fillon të aplikohet forma e zgjedhjes së Kryetarëve të komunave në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët. Në zgjedhjet e vitit 2007 dhe ato të vitit 2009, mandatin për ta udhëhequr komunën e ka fituar Nexhat Demaku, i cili aktualisht po e përmbyll vitin e tretë, në mandatin e dytë në këtë pozitë.

Drenasi me 58.531 banorë, kategorizohet në mesin e komunave mesatare, krahas komunës së Lipjanit, Rahovecit, Skenderajt, Suharekës dhe Malishevës të cilat kanë afërsisht numër të njëjtë banorësh. Ligji për ndarjen e kufijve administrativ i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, Komunën e Drenasit e emërton si Komuna e Glllogocit, por edhe përkundër kësaj, kjo që nga pas lufta njihet si Drenas.<sup>1</sup>

PDK, në Drenas e ka mbajtur shumicën absolute të vendeve edhe në Kuvendin Komunal. Aktualisht, nga 31 asamblistë sa numëron Kuvendi i Drenasit, 24 janë ulëse që i mban PDK, dy ulëse i ka Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dy ulëse Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), dhe me nga një ulëse përfaqësohen Aleanca Kosova e Re (AKR), Partia e Drejtësisë (PD) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Në këtë raport, i cili mbulon zhvillimet rreth politikave publike në komunën e Drenasit për periudhën janar 2010 - shtator 2012, Instituti GAP ka përmendur problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët e Drenasit, ka analizuar performancën buxhetore, investimet kapitale, aktivitetet e prokurimit publik, gjendjen në administratë, arsim dhe shëndetësi, transparencën e Komunës, si dhe ka matur realizueshmërinë e premtimeve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore të 2009.

## 2. Problemet në Komunën e Drenasit

Përpos problemeve të ndotjes të shkaktuara nga fabrika e Feronikelit , shpërthimeve të kohë pas kohshme në këtë fabrikë, papunësisë së lartë dhe numrit gjithnjë e në rritje të familjeve nën asistencën sociale, banorët e Komunës së Drenasit ballafaqohen edhe me mungesë të ujit të pijes, mungesë të rrjetit të kanalizimit, prezencë të deponive të egra të mbeturinave, kontaminim të rrjedhës së lumit “Drenica”, mungesë të kabinave për pritjen e autobusëve, mungesë të parkingjeve për vetura e deri te shpërfaqja e problemit

---

<sup>1</sup> Kuvendi i Kosovës. Ligji për ndarjen e kufijve administrative të komunave. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L041\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L041_al.pdf)

nga krijimi i stoqeve me ilaçe të dala afati pothuajse në të gjitha qendrat shëndetësore të këtij rajoni.

Nga shpërthimi që ndodhi në fabrikën e Feronikelit në gusht të vitit 2011, u patën regjistruar qarje dhe dëmtime në 36 shtëpi përreth kësaj fabrike dhe dëmtime pati pësuar edhe shkolla fillore "Halil Bajraktari", e cila sipas standardeve të sigurisë së objekteve aktualisht nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin në të. Komuna kishte formuar një komision për verifikimin dhe vlerësimin e dëmeve, i cili pat konstatuar se dëmi i përgjithshëm që duhet kompensuar nga ana e fabrikës kap shifrën e 180 mijë eurove. Kryetari i Komunës pat deklaruar menjëherë pas shpërthimit se do ta detyrojë fabrikën që t'i kompensojë dëmet eventuale. Mirëpo, pas vlerësimeve të komisionit përgjegjësit e fabrikës kanë refuzuar t'i paguajnë dëmet me arsyetimin se komisioni ka qenë i njëanshëm dhe se fabrika nuk ka pasur përfaqësues në komision.

Komuna e Drenasit në të kaluarën është llogaritur si njëra ndër komunat me gjendje të kënaqshme të furnizimit me ujë të pijes. Gjatë dy viteve të fundit, kjo ka ndryshuar dhe pjesa dërmuese e vendbanimeve të Drenasit përballen me reduktime të shumta të ujit të pijes. Ndërtesat e banimit kolektiv në qytet gjatë verës së fundit, kanë pasur vetëm nga tetë orë ujë të pijes dhe atë kryesisht gjatë natës. Gjendje edhe më e rëndë është paraqitur në fshatra si në Arbëri, Terstenik, Gllobar, Llapushnik, Polluzh, Shtutic, Tërdevc. Pa ujë të pijes tash e tre vite ka mbetur edhe shkolla "Zenel Hajdini" në Terstenik me mbi 500 nxënës, ku nxënësit detyrohen të marrin ujin me vete në çanta.

Autoritetet komunale të Drenasit nuk janë treguar efikas në menaxhimin e mbeturinave në zonat e kësaj komune. Rreth 80 deponi të egra llogariten të jenë gjithandej Drenasit. Në pjesën më të madhe të kohës, këto deponi qëndrojnë të nderzura, duke rritur nivelin e ndotjes së ajrit dhe rrezikuar seriozisht shëndetin e popullatës. Në brendi të qytetit të Drenasit nuk hasen askund të vendosura shporta të vogla për hedhjen e mbeturinave të imta, me përjashtim të sheshit "Fehmi Lladrovci".

Problemi i mbeturinave ka përfshirë edhe lumin më të madh të kësaj komune, lumin "Drenica", i cili është i mbuluar me mbeturina. Pjesa më e madhe e zonave përreth lumit, kanalizimet i derdhen në lum, duke kontaminuar kështu ujin e lumit. Asnjë investim nuk ka pasur gjatë tri viteve të fundit në rregullimin e këtij lumi, ndonëse planet për rregullimin e shtratit të tij ekzistojnë qysh nga vitit 2008.

Përgjegjësit e Komunës së Drenasit janë treguar të pa interesuar për të rregulluar dhe mirëmbajtur vendet e gjelbëruara në qytetet. Ato pak investime të bëra në krijimin e parqeve janë përcjell me mos mirëmbajtjen e tyre, gjë kjo e cila ka shkaktuar dëmtimin e tyre gradual. I tillë është parku më i madh i qytetit i cili gjendet pak metra larg sheshit "Fehmi Lladrovci", i cili u pat rregulluar në verën e vitit 2010, por gjendja e tij aktuale është e keqe dhe ai park nuk mund të shfrytëzohet për pushim apo rekreacion.

Në oborrit e QKMF (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare) si dhe në nëntë ambulanca të tjera të Komunës së Drenasit kanë në oborret e tyre sasi të mëdha të barnave me afat të skaduar. QKMF-ja ka formuar një komision në krye me mjekun Bashkim Gllareva, i cili ka konstatuar se mbetja e atyre barnave ka ardhur edhe nga papërgjegjësia e stafit mjekësor për t'i dedikuar dhe menaxhuar ato barna në formën e duhur. Në mesin e barnave me afat të skaduar hasen edhe insulina dhe barna nga lista esenciale për të cilat qytetarët e Drenasit obligohen t'i blejnë me paratë e tyre në barnatoret private të qytetit.

Një problem tjetër serioz më të cilin ballafaqohen qytetarët e Drenasit është ai i mungesës së vendeve për parkim të veturave. Asnjë investim komunal nuk është bërë me qëllim të tejkalimit të këtij problemi. Veturat shihen të parkuara vend e pa vend, shumica në trotuare. Kjo dukuri ka prishur edhe pamjen e qytetit.

Një problematikë tjetër e cila e përcjellë në vazhdimësi Komunën e Drenasit është dëmtimi nga ana e qytetarëve të mjeteve publike, si kabinave për pritjen e autobusëve, shtyllave të ndriçimit publik, ulëseve në qytet, shenjave të komunikacionit, pusetave të kanalizimeve e kështu me radhë. Autoritetet komunale janë ndjerë të pafuqishme për të ndaluar këtë dukuri. Dëmtimi i tyre vërehet në shumë zona të kësaj komune.

### 3. Performanca buxhetore e Komunës së Drenasit

Shkalla e të hyrave komunale nga Komuna e Drenasit ka shënuar rritje solide në vitin e fundit, por kjo komunë kategorizohet me të hyrat më të vogla në krahasim me komunat tjera të vendit të cilat janë të përafërta për nga numri i popullsisë dhe territorit me Komunën e Drenasit. Kështu, Komuna e Drenasit, ka me pak të hyra se Komuna e Lipjanit, Rahovecit, Suharekës, Skenderajt, ndonëse këto komuna kanë dal të kenë numër edhe me të vogël të popullsisë se Komuna e Drenasit. Të hyra të përafërta Drenasi ka me Komunën e Istogut e cila ka rreth 40.000 banorë.

Tabela nr.1: Krahasimi i të hyrave komunale mes komunës së Drenasit dhe komunave të përafërta për vitin 2011<sup>2</sup>

Komunat	Shuma/euro
Drenas	837.000
Lipjan	1.570.000
Suharekë	1.635.000
Skenderaj	1.212.000

<sup>2</sup> Nga regjistrimi i fundit i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave ka rezultuar që Komuna e Drenasit ka gjithsejtë 58.531 banorë, numër ky i përafërt me komunat e krahasuara në tabelën e mësipërme, përkatësisht Komuna e Lipjanit ka dal t'i këtë 57.605 banorë, ajo e Suharekës 59.722, Skenderaj 50.858 banorë, Rahoveci me gjithsejtë 56.208 banorë, përderisa Istogu ka 39.289 banorë.

Rahovec	887.000
Istog	809.000

Krahasimi i të hyrave komunale nga viti në vit, nxjerr në pah një rritje të vogël të shkallës së të hyrave komunale në Drenas. Kështu gjatë vitit të fundit 2011, Komuna e Drenasit ka pasur gjithsej 837.000 euro të hyra. Një vit me herët në 2010, shuma e të hyrave komunale ka qenë rreth 771.000 euro, kurse gjatë nëntë muajve të këtij viti, Komuna e Drenasit ka realizuar të hyra në vlerë prej 520.299 eurove.

Shuma totale e buxhetit që ka Komuna e Drenasit në dispozicion, gjatë një viti sillet rreth 10 milionë euro. Nga kjo rezulton se mbi 94% e buxhetit të Komunës së Drenasit përbëhet nga granti qeveritar që dedikohet për komuna si dhe grantet shtesë për arsim dhe shëndetësi. Komuna e Drenasit nuk pritet të ketë ndonjë ndryshim të madh nga efektet e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, ngase komisioni për ndarjen e granteve për komuna në bazë të numrit të supozuar të banorëve ka llogaritur deri tani se Komuna e Drenasit ka 60.000 banorë, shifër kjo e përafërt me rezultatin e publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për numrin e banorëve në atë komunë.<sup>3</sup>

Tabela nr.2: Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Drenasit për 2012

Kategoria	Shuma (euro)
Investime kapitale	2.773.508
Mallëra dhe shërbime	796.979
Subvencione dhe transfere	127.774
Shpenzime komunale	144.104
Paga dhe mëditje	5.978.136
<b>Gjithsej</b>	<b>9.820.501</b>

Nga të dhënat e prezantuara në tabelë vihet në pah një shumë relativisht e lartë e parave të dedikuara në kategorinë e mallërave dhe shërbimeve. Shuma prej 796.979 euro për këtë kategori është e përafërt me shumën totale që kjo komunë realizon të hyra për një vit. Krahasimi i shifrave që Komuna e Drenasit dedikon në mallëra dhe shërbime me komunat e përafërta me këtë komunë si Lipjani, Malisheva, Rahoveci, Skenderaj, nxjerr në pah se Drenasi ka shumëfish me shumë buxhet në këtë kategori se komunat tjera, ndonëse këto të fundit shkallën e të hyrave komunale e kanë me të lartë se Drenasi.

<sup>3</sup> Instituti për Studime të Avancuara GAP. Analiza mbi të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe efektet e tyre në politikat publike. Burimi <http://www.institutigap.org/repository/docs/GAPanalizepertedhenateASK.pdf>



Tabela nr.3: Krahasimi mes komunës së Drenasit dhe komunave të tjera për shumën e buxhetit që dedikojnë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve

Komunat	Shuma (euro)
Drenas	797.979
Lipjan	752.815
Malishevë	713.437
Istog	585.037
Skenderaj	767.460
Rahovec	740.367

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se Komuna e Drenasit ka të dedikuar buxhet në kategorinë e mallërave dhe shërbimeve shumëfish më shumë së komunat tjera të përfaqësuara me komunën e Drenasit. Nga linja e buxhetit për mallëra dhe shërbime kryhen pagesat për derivate dhe lëndë djegëse, darka dhe dreka zyrtare, udhëtime, mëditje, ushqim, shpenzime telefonike, mirëmbajtje të objekteve dhe veturave, blerja e mobileve dhe pajisjeve të tjera si dhe pagesat eventuale për qiramarrje.

Komuna e Drenasit vetëm në vitin e fundit 2011, për telefona, dreka dhe darka zyrtare si dhe karburant për vetura ka shpenzuar mbi 121.000 euro.

Tabela nr.4: Shumat e shpenzuara nga Komuna e Drenasit në disa kategori gjatë vitit 2011

Kategoria	Shuma (euro)
Karburante për vetura	71.341,93
Dreka dhe darka zyrtare	29.960,20
Telefon mobil	8.125
Telefon fikës	11.638,20
<b>Gjithsej</b>	<b>121.066,03</b>

Tabela nr.5: Krahasimi i shpenzimeve për karburante për vetura, dreka zyrtare dhe telefonata zyrtare në mes të komunës së Drenasit dhe komunave të përfaqësuara

Komunat (2011)	Kategoria		
	Karburant për vetura (euro)	Dreka zyrtare (euro)	Telefona zyrtar (fiks dhe mobil) (euro)
<b>Drenasi</b>	71.341,93	29.960,20	19.763,20
<b>Malisheva</b>	107.677	27.722	18.161
<b>Lipjani</b>	67.299	23.864	16.014
<b>Vitia</b>	78.868	29.822	30.818

Nga të dhënat e mësipërme shihet se Komuna e Drenasit ka shpenzuar më shumë se Komuna e Malishevës, Lipjanit dhe Vitisë në dreka dhe darka zyrtare si dhe në telefona mobil dhe fiks.

Komuna e Drenasit gjatë një viti shpenzon mbi 220.000 euro për lëndë djegëse, ku hyjnë derivatet për vetura, karburante për generator, naftë për ngrohje si dhe për blerjen e druve dhe thëngjillit. Nga 220.000 eurot e shpenzuara në këtë drejtim, 71.341,93 euro janë shpenzuar për karburante për vetura zyrtare.

Tabela nr.6: Krahasimi i shpenzimeve në katër vitet e fundit nga Komuna e Drenasit në dreka dhe darka zyrtare

Dreka Zyrtare	
Viti	Shuma (euro)
2011	29.960,20
2010	25.340
2009	62.860
2008	21.420

Në katër vitet e fundit, Komuna e Drenasit vetëm për dreka dhe darka zyrtare ka shpenzuar mbi 139.580 euro. Viti i zgjedhjeve lokale në vend, 2009, është karakterizuar me shifrën me të madhe të shpenzimit të parasë publike për këtë kategori, me ç'rast janë shpenzuar 62.860 euro, apo rreth 37.520 euro më shumë se një vit me vonë (2010).

Kjo Komunë ka shpenzuar shuma relativisht të larta edhe për projekte të tjera. Gjatë vitit 2011 janë bërë edhe këto shpenzime:<sup>4</sup>

- Riparimi i ujësjellësit në gjimnazin "Skënderbeu" në Drenas ka kushtuar 9.921 euro.
- Hapja e pusetave në qytet ka kushtuar 6.000 euro.
- Bartja e këshilltarëve komunal nëpër Kosovë për një ditë i ka kushtuar buxhetit të Komunës së Drenasit 8.000 euro.
- Blerja e topave dhe rekuizitave ka kushtuar 10.000 euro.
- Për rregullimin e kanalizimit në fshatin Krajkovë janë shpenzuar 3.924 euro kurse për organizimin e një manifestimi të humorit janë shpenzuar 3.630 euro.
- Për servisimin dhe mirëmbajtjen e veturave zyrtare Komuna e Drenasit gjatë një viti shpenzon afro 19.000 euro.<sup>5</sup>

<sup>4</sup> Komuna e Drenasit. Raporti i punës së Kryetarit për vitin 2011. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/gllgoc/getattachment/40c48ca2-6a97-4cd5-bf47-a1c1d6e6aa5e/RAPORTI-VJETOR-I-PUNES-PER-VITIN-2011.aspx>

<sup>5</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. Burimi: <http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=38428>

Tabela: nr.7: Shumat e shpenzuara nga Komuna e Drenasit në disa kategori gjatë nëntë muorit të 2012

Kategoria	Shuma (euro)
Shpenzimet për telefoni fikse	7.710
Lëndë djegëse	113.890
Mirëmbajtje të objekteve dhe riparim të veturave dhe pajisjeve	61.500
Shpenzimet e marketingut	18.390
Darka dhe dreka zyrtare	22.410

## 4. Investimet kapitale

Komuna e Drenasit gjatë tri viteve të fundit ka shënuar përparim të dukshëm në rregullimin e rrugëve, trotuareve, shkollave si dhe ka pasur investime të gjëra në rregullimin e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit. Investimet në këtë komunë kanë qenë të dukshme edhe nga ana e ministrive të linjës, veçmas nga Ministria e Infrastrukturës dhe ajo e Arsimit. Komuna e Drenasit, gjatë një viti për investime kapitale dedikon afro 2.8 milionë euro.

Megjithatë, shqetësuese mbetet cilësia e dobët e punimeve dhe planifikimi jo i duhur i investimeve. Në disa raste njëherë është shtruar rruga dhe pas një kohe autoritetet janë detyruar ta prishin rrugën me qëllim të instalimit të rrjetit të kanalizimit apo ujësjellësit. Kjo ka ngjarë disa herë në zonat urbane të qytetit. Mos planifikimi i mirë ka rezultuar që sheshi “Fehmi Lladrovci” brenda tri viteve është ristrukturuar e riparuar katër herë radhazi nga kompani të ndryshme dhe me kosto të ndryshme. Faza e parë është kryer nga kompania “Diamanti”<sup>6</sup>, faza e dytë nga kompania “Përparimi”<sup>7</sup>, kurse faza e tretë dhe e katërt nga kompania “Kosbau”.<sup>8</sup> Në fund të vitit 2009, përgjegjësit e Komunës së Drenasit patën vendosur ta ndërtojnë një skenë në formë të betonit i cili tek pas ndërtimit është konstatuar se paraqet shëmtim të pamjes së sheshit dhe kësaj dy vite më vonë, në qershor 2011, skena është demoluar dhe larguar nga hapësira e sheshit. Ndërtimi i asaj skene pat kushtuar rreth 25.000 euro, ndërsa demolimi dhe largimi mbi 9.000 euro. E gjithë kjo ka ndodhur si rezultat i mos planifikimit të duhur nga ana e përgjegjëseve të Komunës së Drenasit.

Cilësia e projekteve të realizuara në sferën e infrastrukturës rezulton të jetë e dobët. Disa rrugë pak kohë pas ndërtimit të tyre janë kthyer pothuajse në gjendjen në të cilën kanë qenë para rregullimit apo asfaltimit. Të kësaj natyre janë rruga Drenas – Baice,

<sup>6</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. Burimi: <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=2919>

<sup>7</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. Burimi: <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=10598>

<sup>8</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. Burimi: <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=22538>

rruga për Shtutic, rruga për Çikatovë të Re, rruga që të shpije te ura e Baices e kështu me radhë.

Tabela nr 8.: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Drenasit të realizuara gjatë vitit 2011

<b>Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011</b>	<b>Shuma (euro)</b>
Asfaltimi i rrugës në relacionin Krajkov - Damanek	86.902,50
Asfaltimi i rrugës në Fushicë të epërme	25.930
Asfaltimi i rrugës në fshatin Fatos	39.906
Asfaltimi i rrugës në lagjen e quajtur "Zogu"	140.807,50
Asfaltimi i rrugës në lagjen e re të Komoranit	48.737,50
Asfaltimi i rrugës në lagjen e quajtur "Heta" dhe "Qorri"	50.605,60
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Terdevc	23.659
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Krajkov	8.924
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Likoshan	14.520
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Koroticë e epërme	10.529
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Zabel i ulët	16.729
Asfaltimi i rrugës në fshatin e quajtur Poklek i vjetër	27.162
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Terstenik	4.390
Asfaltimi i rrugës në Vasilevë	13.553

Në disa projekte të Komunës ka munguar transparenca e plotë në lidhje me koston e ndërlidhur të ndërtimit si dhe me ecurinë e përgjithshme të punimeve. Ndërtimi i sheshit "Fehmi Lladrovci" është përcjellë me rrënimin e afro 30 lokaleve afariste të cilat kanë ushtruar veprimtari të ndryshme. Pas rrënimit, pronarët e këtyre lokaleve i janë drejtuar gjykatave kompetente duke kërkuar kompensim dhe dëmshpërblim të humbjeve. Komuna ka dhënë për çdo vit para në këtë drejtim, por asnjëherë Ekzekutivi nuk ka pranuar të dërgojë raport në Kuvend se kush është kompensuar, sa është numri i pronarëve të kompensuar dhe sa është shuma e parave të kompensuar. Kjo çështje disa herë radhazi është ngritur nga opozita në Kuvendin Komunal të Drenasit.

Tabela nr 9: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Drenasit të realizuara gjatë vitit 2010

<b>Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010</b>	<b>Shuma (euro)</b>
Ndërtimi i infrastrukturës në lagjen e Dëshmoreve	120.000
Ndërtimi i rrugës së quajtur Godanc	50.000
Ndërtimi i rrugës në lagjen "Bytyqi" në Arllat	50.000
Ndërtimi i rrugës në lagjen "Gjokaj"	81.951
Ndërtimi i rrugës në zonën e quajtur Vuçak	63.222,55
Ndërtimi i rrugës në relacionin për Negoc	90.000
Ndërtimi i rrugës në Baicë	63.770
Kanalizimi në fshatin Polluzhë	16.068
Asfaltimi i rrugës në Terdevc 'Faza e dytë'	21.247,42

Asfaltimi i rrugës së quajtur “Dritan”	50.000
Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Likoshan	18.657,50
Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Arbri	24.471
Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Gllanasell	19.315
Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Koreticë e ulët	42.560

Për shkak të veprimeve kontestuese të ndërmarra nga Komuna, disa zyrtarë nuk kanë dashur t'i zbatojnë ato. Kësisoj, ish Drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Liman Krasniqi, ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij si drejtor në gjysmën e dytë të vitit 2009 me arsyetimin zyrtar se nuk dëshiron të bëhet shkelës i ligjit duke dhënë leje ndërtimi për objektin i cili është dhënë nga Komuna me koncesion përball objektit komunal. Shkelja e ligjit ka konsistuar në pikën që leja e ndërtimit është kërkuar për objektin p+9 (përdhese plus nëntë kate), përderisa plani rregullues për atë zonë ka paraparë maksimalisht ndërtim në lartësi p+7. Me ardhjen e drejtorit të ri Ajet Demiri në krye të Drejtorisë së Urbanizimit, është dhënë leja për p+9. Ndërtimin e këtij objekti, përkatësisht procedurat e koncesionit janë kryer mes Komunës së Drenasit dhe kompanisë “Kulla” e cila menaxhohet nga ish kryesuesi i Kuvendit Komunal të Drenasit Idriz Hisenaj. Në kohën kur është lidhur marrëveshja e koncesionit (në fund të vitit 2008), Idriz Hisenaj ka qenë akoma duke ushtruar funksionin e kryesuesit të Kuvendit Komunal.<sup>9</sup>

Shkolla fillore, “Halil Bajraktari,” është ndërtuar nga Komuna e Drenasit në një pronë të kontestuar. Prona ka qenë e familjes Hasi. Kjo familje ka dorëzuar kërkesë me qëllim të verifikimit të pronësisë tek Agjencia Kosovare e Pronës (AKP). APK ka nxjerrë vendim në favor të familjes Hasi. Pastaj e njëjta familje iu ka drejtuar Gjykatës Komunale, e cila po ashtu ka marrë vendim në favor të familjes Hasi. Pastaj një vendim e ka nxjerrë edhe Gjykata Supreme në favor të familjes Hasi. Por, asnjëra nga këto vendime nuk është përfillur nga ana e Komunës së Drenasit e cila tokën e familjes Hasi e quan tokë të tjetërsuar gjatë viteve 1989 - 1999. Në fillim të muajit shtator të këtij viti, Kryetari i Komunës, Nexhat Demaku, së bashku me dy zyrtarë të tjerë komunal është paraqitur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Kjo gjykatë ka ngritur aktakuzë ndaj udhëheqësve të Drenasit me arsyetimin e cënimit të pronës private dhe mos zbatimin e vendimeve të nxjerra nga instancat e nivelit qendror. Aktakuza është ngritur nga prokurorja Drita Hajdari dhe deri më tani janë mbajtur disa seanca gjyqësore, por ende nuk janë marrë vendime të prera. Nga kjo lëndë gjyqësore, kryetari i Komunës, Nexhat Demaku, drejtori i Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës, Mehdi Kurrumeli dhe zyrtari i lartë komunal, Shefqet Morina, mund të marrin dënimin deri në 10 vite burgim me aktakuzën e ngritur për shpërdorim të detyrës zyrtare, mos pranimit të pronës private.

<sup>9</sup> Koncesionimi nënkupton se komuna jep pronën komunale një personi apo subjekti i cili e ndërton një objekt apo projekt të caktuar dhe brenda atij objekti një përqindje i dedikohet komunës për interes të përgjithshëm.

## 5. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2011

Komuna e Drenasit fushën e prokurimit publik e ka të rregulluar në nivel të zyrës e cila sipas organogramit funksionin brenda Drejtorisë së Administratës. Kjo zyre ka gjithsej tre të punësuar, ku njëri nga ta mban pozitën e Shefit të Zyrës së Prokurimit. Për dy vite (2010-2011), Komuna e Drenasit ka lidhur 380 kontrata nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, me një vlerë të kontratave mbi 6 milionë euro.

Tabela nr.10: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Drenasit 2010 -2011

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (euro)
2010	181	3.118.626,50
2011	199	3.126.282,71
Gjithsej	380	6.244.909,21

Burimi: KRPP Raporti për 2010 dhe 2011

Komuna e Drenasit gjatë tri viteve të fundit është karakterizuar me favorizime të kompanive dhe personave që në një mënyrë apo tjetrën kanë lidhje farefisnore dhe partiake me udhëheqësit e komunës. Kësisoj, kompania private e quajtur “Gjoka” e cila udhëhiqet nga daja i Kryetarit të Komunës, kryen pjesën dërmuese të punëve në komunë përmes tenderëve komunal. Kompania “Gjoka” ka njëkohësisht nën pronësi edhe pompën e benzinës të quajtur “Fer petrol”.<sup>10</sup> Të gjithë tenderët në komunë për furnizim me naftë dhe derivate djegëse kontraktohen nga Komuna në këtë kompani. Komuna e Drenasit i ka dhënë të njëjtës kompani edhe tokë komunale në shfrytëzim në fshatin e quajtur Gllöbar. Daja i Kryetarit të Komunës ka hapur edhe firmë për asfaltimin e rrugëve, dhe vetëm këtë vit ka fituar disa projekte, ndër to asfaltimin e rrugës së fshatit Terstenik, përkatësisht tek lagja Cakiqi dhe në fshatin Baice.

Pastaj, firma private “Vëllezërit Thaçi” udhëhiqet nga asamblisti i PDK-së në Kuvendin Komunal, Elmi Thaçi. Kjo kompani ka marrë tender për bartjen e nxënëseve në 11 relacione të Komunës së Drenasit. Komisioni mbikëqyrës për këtë punë që udhëheqet nga Aziz Morina (zyrtar i arsimit) ka konstatuar parregullsi evidente gjatë bartjes së nxënëseve në relacionet e parapara. Në mesin e këtyre parregullsive ka qenë verifikimi i komisionit se minibuset janë vozitur nga personat nën moshën 18 vjeçare (pa patentë shofer), se minibuset janë mbingarkuar me nxënës - si dhe komisioni ka gjetur rastin kur minibuset kanë aksidentuar apo shkelur me autobus dy nxënës në fshatin Terstenik duke u shkaktuar atyre lëndime trupore. Vlera e parave që kompania “Vëllezërit Thaçi” kanë marrë nga Komuna në gjysmë vjetorin e parë të mësimit për vitin 2012 ka qenë mbi 55 mijë euro. Edhe përkundër të gjeturave dhe konstatimeve të komisionit komunal, kompania “Vëllezërit Thaçi” kanë fituar prapë tenderin për bartjen e nxënëseve në gjysmë vjetorin e dytë të këtij viti në 6 relacione të ndryshme të komunës

<sup>10</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. Burimi: <http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=40047> & <http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=35953>

së Drenasit. Ndërsa për 5 relacione të tjera, Komuna i ka dhënë tenderin firmës 'Lindi-AD', që është firmë bashkëpunuese me firmën 'Vëllezërit Thaçi'.

Edhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) në raportin i cili i referohet periudhës së vitit të kaluar (2011) ka konstatuar parregullsi serioze në sferën e prokurimit publik. Sipas këtij raporti në tenderin për asfaltimin e rrugës "Heta dhe Qorri" operatori ekonomik "Trasing Grup" ka ofertuar me dy oferta të ndryshme dhe atë një të ofertë në emër të vetin dhe ofertën tjetër duke lidhur marrëveshje për furnizim me asfalt me operatorin ekonomik "Vëllezërit Beqiri". Ky i fundit ishte shpallur fitues, deri sa kishte marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë "Trasing". Sipas rregullave të prokurimit, operatori i cili është në marrëveshje me një operator tjetër, duhet të konkurrojë si grup dhe duhet të konfirmojë pjesëmarrjen në grup. Komuna e Drenasit nuk e ka kontestuar dhe as anuluar një tender të tillë të bërë me marrëveshje mes operatoreve privat.<sup>11</sup>

Po sipas raportit të ZAP-it, më datën 19.05.2011 ishte paguar fatura nga Komuna e Drenasit në vlerë prej 5.745 euro në emër të derivateve për shoqatat e dala nga lufta dhe në këtë rast është vërejtur se komuna nuk ka ndonjë marrëveshje apo memorandum me përfituesin. Auditori nuk ka gjetur dëshmi të mjaftueshme se pagesa e kryer është në përputhje me shpenzimet e ndodhura.

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), në së paku një rast ka konstatuar se Komuna e Drenasit ka bërë shkelje të rregullave të prokurimit gjatë dhënies së tenderëve për punë publike. Kësisoj, OSHP ka urdhëruar autoritetet e prokurimit në Drenas që të shkojnë në ri-tenderim në rastin e ndërtimit të rezervarit të ujit të pijes në Drenas, ngase janë konstatuar shkelje të rregullave të prokurimit.<sup>12</sup>

## 6. Administrata e Komunës së Drenasit

Komuna e Drenasit me gjithsej 10 Drejtori si dhe me sektorët e tjerë ndërlidhës ka 162 të punësuar, pa llogaritur këtu edhe numrin e të punësuarve në sektorin e arsimit fillor dhe atë të mesëm si dhe në sferën e shëndetësisë. Bashkë me sektorët e fundit, numri i të punësuarve në Komunën e Drenasit është 1.313 persona.

---

<sup>11</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Komunën e Drenasit - 2011. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KDR\\_2011\\_Shqip\\_601539.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KDR_2011_Shqip_601539.pdf)

<sup>12</sup>Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimet e Publikuara. Burimi: [http://oshp.rks.gov.net/repository/docs/vendimet/2010/nder\\_rezerv\\_kamen\\_tet10.pdf](http://oshp.rks.gov.net/repository/docs/vendimet/2010/nder_rezerv_kamen_tet10.pdf)



Tabela nr.11: Numri i të punësuarve sipas sektorëve në Komunën e Drenasit

Sektorët	Numri i të punësuarve
Zyra e Kryetarit	10
Drejtoria e Administratës	34
Drejtoria e Inspektionit	9
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	13
Drejtoria për Shërbime publike dhe emergjenca	23
Zyra për Komunitete	1
Drejtoria për Bujqësi	12
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	12
Drejtoria e Urbanizimit	10
Drejtoria e Shëndetësisë	5
Drejtoria e Arsimit	8
Drejtoria për Kulturë	12
Dega për Punë Sociale	13
<b>Gjithsej</b>	<b>162</b>

Numri i të punësuarve femra në dikasteret e Komunës së Drenasit është tejet i vogël. Po ashtu vihet re se të punësuarat femra në Komunë janë përgjithësisht më shkollim fillor dhe atë të mesëm. Nga 162 të punësuar në Komunë, 28 janë femra dhe 134 meshkuj. Ndërkaq sa i përket përgatitjes arsimore të tyre, 3 janë me shkollim fillor, 81 me shkollim të mesëm, 11 me shkollim të lartë dhe vetëm 67 me shkollim universitar. Thënë ndryshe, vetëm 41% e të punësuarve në këtë komunë janë me shkollim universitar.

## 7. Arsimi në Komunën e Drenasit

Gjendja në infrastrukturën e shkollave në Komunën e Drenasit është përmirësuar dukshëm në tri vitet e fundit. Në dy fshatrat e kësaj ane (Gllobar dhe Negrovc) ku mësimi është zhvilluar në baraka të improvizuara si objekte shkollore, tani kjo është evituar dhe në ato lokalitete janë ndërtuar objektet e reja. Investimet në arsim kanë qenë evidente, por edhe pavarësisht kësaj disa probleme të natyrës infrastrukturore mbesin, siç është rasti me shkollën fillore në fshatin Orllat, ku fillimi i vitit shkollor 2012-2013 ka filluar me bojkotim të mësimit për dy javë nga ana e nxënësve me arsytimin e mungesës së kushteve elementare për mësim. Po ashtu edhe në shkollën fillore në fshatin Kishnarekë, objekti shkollor nuk plotëson as për së afërmi kushtet e nevojshme për zhvillimin e mësimit. Mësimi në Komunën e Drenasit, deri në fund të vitit 2011 është zhvilluar në tri ndërrime, por kjo praktikë është evituar me përmirësimin dhe zgjerimin e hapësirave të reja për mësim. Aktualisht, vetëm në shkollën “Rasim Kiqina”



zhvillohet mësimi në tri ndërrime. Një dukuri që e ka përcjellë në vazhdimësi sistemin arsimor në Komunën e Drenasit është punësimi i stafit mbi baza familjare. Në këtë rreth është involvuar edhe Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Drenasit, Arsim Mehmeti. Ai ka punësuar pjesën dërmuese të familjareve të tij në sistemin arsimor fillor dhe atë të mesëm në shkollat e komunës. Një vëlla e ka punësuar si staf teknik në shkollën “Halil Bajraktari”, një vëlla tjetër si mësimdhënës në shkollën e mesme “Gjergj Kastrioti -Skënderbeu” në Drenas, motrën e ka punësuar në shkollën fillore “Mehmet Gradica” si mësimdhënëse dhe po ashtu ka punësuar bashkëshorten në shkollën fillore “Rasim Këçina” në qytetin e Drenasit.

Komuna e Drenasit ka gjithsej 27 shkolla fillore dhe dy shkolla të mesme, shkollën e mesme profesionale (teknike) “Fehmi Lladrovci” dhe gjimnazi gjuhësor-natyror “Skënderbeu”.

Tabela nr.12: Numri i mësimdhënësve dhe stafit përcjellës në 27 shkollat fillore të Drenasit:

Gjinia	Numri i mësimdhënësve	Stafi ndihmës
Femra	238	3
Meshkuj	363	152
Gjithsej	601	155

Tabela nr.13: Numri i mësimdhënësve dhe stafit përcjellës në shkollat e mesme të Drenasit:

Gjinia	Numri i mësimdhënësve	Stafi ndihmës
Femra	42	2
Meshkuj	116	25
Gjithsej	158	27

Tabela nr.14: Numri total i mësimdhënësve, nxënësve dhe stafit ndihmës në 27 shkolla fillore dhe dy shkolla të mesme në Komunën e Drenasit

Kategoria	Numri	F	M
Mësimdhënës	759	280	479
Nxënës	13.778	6.604	7.174
Stafi ndihmës	209	5	204

Në Komunën e Drenasit ekziston edhe çerdhja e qytetit “Ardhmëria” ku janë të sistemuar afro 160 fëmijë. Në këtë çerdhe janë të punësuar 22 persona, prej tyre 11 janë në rolin e edukatoreve, ndërsa pjesa tjetër staf ndihmës. Edhe Komuna e Drenasit e ka të organizuar sistemin e mësimi para-fillor, ku mësimin në këtë nivel e ndjekin afro 830 fëmijë.

Shikuar nga të dhënat e prezantuara nga Drejtoria e Arsimit e Komunës së Drenasit cilësia e arsimit në shkollat e kësaj komune ka shënuar ngritje nga viti në vit, por përqindja totale e kalueshmërisë së testit shtetëror të maturës mbetet akoma e ulët.<sup>13</sup>




Tabela nr.15: Disa nga investimet gjatë 2010 - 2011 në infrastrukturën e shkollave të Drenasit

Investimet	Shuma/euro
Renovimi dhe ndërtimi i aneksit të shkollës "Naim Frashri" në fshatin Bletar	223.915
Ndërtimi i objektit të ri të shkollës së mesme teknike "Fehmi Lladrovci"	2.600.000 <sup>14</sup>
Rregullimi i pesë fushave sportive në oborret e shkollave	52.984
Renovimi i shkollës fillore në Orllat	9.619
Rregullimi i oborrit të shkollës së mesme "Skënderbeu"	9.716
Renovimi i objektit të shkollës fillore në Likoshan	11.000
Investime në rrjetin e brendshëm të shkollave për ngrohje	28.600
Blerja e kompjuterëve për shkollat fillore	11.200
Ndërrimi i dyerve të dritareve, kërrigave, bankave si dhe rregullimi i rrethojave nëpër oborret e shkollave	56.840

<sup>13</sup> Komuna e Drenasit. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2011. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gllgoc/Municipality/President/President-Report.aspx>

<sup>14</sup> Investim i Qeverisë së Kosovës.

## 8. Shëndetësia në Komunën e Drenasit

Komuna e Drenasit ka arritur të bëjë një shtrirje të gjerë të objekteve shëndetësore me qëllim të ofrimit të shërbimeve elementare me shpejt. Në gjithë territorin e Komunës ekziston një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), pesë Qendra të Mjekësisë Familjare dhe tetë punkte shëndetësore apo ambulanca. Në kuadër të QKMF janë funksionale pjesa dërrmuese e segmenteve mjekësore. Kësisoj, shërbime ofrohen në fushën e mjekësisë familjare, dispanserit të fëmijëve, shërbimet e emergjencës, pneumologji, neuropsikiatri, degën e dispanserit të femrave, maternitet, stomatologji, rëntgen si dhe laborator. QMF si dhe punktet shëndetësore janë të shpërndara nëpër fshatrat e kësaj ane. QMF gjenden në Komoran, Arllat, Terstenik, Gllanasell dhe një në fshatin Baice . Ndërsa punktet shëndetësore apo ambulancat janë në Nekoc, Sankoc, Gradicë, Dobroshec, Abri e Epërme, Poklek, Vasilevë dhe një ambulancë gjendet në fshatin Terdec.

Megjithatë, një karakteristikë e cila e dallon këtë komunë nga të tjerat tek dikasteri i shëndetësisë është prezenca e madhe dhe e vazhdueshme e barnave me afat të skaduar. Në oborrin e QKMF, si dhe në oborret e tetë ambulancave shëndetësore të Komunës së Drenasit ekzistojnë me qindra tonelata barna me afat të skaduar. QKMF-ja ka formuar një komision i cili është kryesuar nga mjeku Bashkim Gllareva, i cili ka konstatuar se mbetja e atyre barnave ka ardhur kryesisht nga papërgjegjësia e stafit mjekësor për t'i menaxhuar ato barna në formën e duhur. Në mesin e barnave me afat të skaduar hasen edhe insulina dhe barna nga lista esenciale, të cilat qytetarët e Drenasit obligohen t'i blejnë me paratë e tyre në barnatoret private të qytetit. Pjesa më e madhe e atyre barnave kanë ardhur si donacion nga shtetet e ndryshme. Ekzistenca e barnave me afat të skaduar shihet me shqetësim nga përgjegjësit e qendrave mjekësore, ngase vjetërsia e tyre është e madhe dhe kohë pas kohe grumbull i tyre kundërmon duke rrezikuar kësisoj edhe kontaminimin eventual të hapësirës në oborret e këtyre qendrave mjekësore. Asgjësimi i këtyre barnave është lënë përgjegjësi e nivelit qendror e cila deri tani nuk ka gjetur formë të përshtatshme për të bërë një gjë të tillë për shkak të specifikave që kërkohen për të asgjësuar produktet farmaceutike.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorët e shëndetësisë në Komunën e Drenasit është gjithsej 183 persona, pjesa më e madhe e tyre në QKMF.

Nga të dhënat e Drejtorisë së shëndetësisë në Komunën e Drenasit rezulton një shifër e lartë e rasteve të prekura nga sëmundjet e frymëmarrjes. Mbi 11 mijë qytetarë kanë kërkuar ndihmën e mjekut gjatë vitit 2011 nga vështirësitë në frymëmarrje.

Tabela nr.16: Numri i rasteve të paraqitura me sëmundje të ndryshme në Komunën e Drenasit gjatë vitit 2011

Sëmundjet	Numri i pacientëve
Vështirësi në frymëmarrje dhe sëmundje të frymëmarrjes	22.196
Sëmundjet e syrit	963
Vështirësi në qarkullimin e gjakut dhe sëmundje te gjakut	5.551
Sëmundje të lëkurës	2.823
Helmime nga faktorët e jashtëm	1.424
Sëmundje e sistemit digjektiv	14.542
Çrregullim i imunitetit	1.201
Sëmundje gjenitale	4.870
Raste me kancer	15

## 9. Transparenca

Zyra për Informim në Komunën e Drenasit funksionon brenda Zyrës së Kryetarit dhe ka vetëm një të punësuar. Kjo zyrtare për informim ka qenë 6 muaj e dënuar nga gjykata për keqpërdorim të procesit zgjedhor gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare në vend dhe për gjashtë muaj pozitën e saj nuk e ka zëvendësuar askush duke shkaktuar kështu vështirësi tek gazetaret dhe të interesuarit e tjerë për të marrë informata nga Komuna për zhvillimet e ndryshme. Në të vërtetë, zyrtarja për informim e ka vuajtur burgun vetëm 3 muaj, por asaj i është shqiptuar edhe dënimi i dytë për mashtrim në procesin e votimit për zgjedhjet e vitit 2010, e që është dënuar serish me 6 muaj burg efektiv. Kjo komunë mbulohet rregullisht nga mediumet e shkruara të cilat kanë të angazhuar korrespondentë nga ky lokalitet. Cilësia dhe sasia e informatave që korrespondentët marrin nga ana e autoriteteve lokale vlerësohet përgjithësisht e kënaqshme. Zhvillimet komunale mbulohen edhe nga ana e dy radiove lokale të cilat edhe për kundër resurseve të kufizuara humane dhe financiare mundohen të informojnë drejt dhe korrekt opinionin për zhvillimet në Komunën e Drenasit. Faqja zyrtare ka informata bazike në lidhje me komunën dhe zhvillimet e përditshme. Dikasteret e komunës përgjithësisht i bëjnë publike raportet, dokumentet dhe materialin tjetër që është me interes për opinionin.

Tabela nr.17: vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Drenasit  
<http://kk.rks-gov.net/glllogoc/>

Dokumenti	2010				2011				2012		
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	√	√	x	√	x	√	√	√	√
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x
Drejtoria për Sherbime Publike dhe emergjenca	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x
Planifikim dhe Urbanizëm	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x
Drejtoria për Kulëturë, Rini dhe Sport	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x
Drejtoria për Bujqësi dhe zhvillim ekonomik	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit	√									√	√
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm	x										
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x				√				√	x	x
Rregulloret Komunale	Të gjitha rregulloret janë të publikuara.										
Vendimet e Kuvendit Komunal	√				√				√	√	√
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	√										
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës	√										

X = mungon raporti. √ = raporti është i publikuar në ueb-faqe.

## 10. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z. Nexhat Demaku, para elektoratit të tij ka shpalosur premtime në sfera të ndryshme. Pas monitorimit të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në fund të 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit iu përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre.

Tabela më poshtë vlerëson progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna më 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 12 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas afro tri viteve të qeverisjes në Komunën e Obiliqit, 5 premtime janë përmbushur, 2 nuk janë realizuar, ndërsa në 5 premtime ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen akoma premtime të përmbushura.

Premtimet e dhëna	Realizueshmëria
Realizimin e 240 projekteve kapitale gjatë mandatit 4 vjeçar	Shifra e projekteve kapitale të investuar nga komuna brenda një viti sillet deri në 35 projekte, nëse këtë shifër e masim për katër vite të mandatit atëherë i bie që do të realizohen 140 projekte, apo 100 me pak se sa që janë premtuar.
Detyrimin e Feronikelit që të vendos filtrat	Feronikeli ka vendosur filtrat gjatë këtij viti, të cilat do duhej të ishin në funksion gjatë 24 orëve të punës, sepse ato monitorohen nga Ministria.
Ndërtimin e Parkut të Biznesit, ku do investojnë kompani të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare dhe ku do të punësohen rreth 600 njerëz.	Parku i biznesit është ndërtuar nga partneriteti mes komunës dhe Qeverisë së Kosovës, por aktualisht aty punojnë rreth 20 persona.
Ndërtimin e një qendre industriale të biznesit, në hapësirën përballë Parkut të Biznesit.	Kjo nuk është bërë dhe as që ka plane në këtë drejtim.
Lidhjen e fshatrave me infrastrukturë rrugore, kanalizim dhe ujësjellës.	Infrastruktura rrugore vlerësohet përgjithësisht e rregulluar, cilësia e saj mbetet larg standardeve të kërkuara. Ka pasur investime edhe në kanalizim dhe ujësjellës, por në shumë lokalitete gypat e ujit nuk janë funksional.
Investimin e mbi 2 milionë eurove në bashkëpunim me USAID-in dhe ujësjellësin "Prishtina", për furnizimin e të gjitha fshatrave me ujë të pijshëm.	Ka pasur një nismë në këtë drejtim. Ky projekt bashkë-financues ka nisur në fund të vitit 2008 dhe ishte premtuar se do të përfundojë gjatë vitit 2011, por ende nuk ka përfunduar. Deri më tani janë nënshkruar 4 memorandume të bashkë-financimit, dhe janë ngritur 2 rezervarë të ujit dhe janë shtrirë gypat në shumë fshatra, por në shumicën prej tyre ende nuk janë në funksion.

Ndërtimin e një shkolle të mesme e cila do t'i ketë 20 klasë dhe do të jetë e pajisur me laboratorë (deri në fund të vitit 2010).	Është ndërtuar shkolla e mesme profesionale në Drenas. Ndërtimi i kësaj shkolle është bere ne bashkëfinancim mes Komunës se Drenasit dhe MASHT-it
Rregullimin e kanalizimit në fshatin Korreticë e Ulët dhe rregullimin e shtratit të lumit Drenica (prioritete për vitin 2010)	Në lum nuk është punuar asgjë, ndërsa kanalizimi ka përfunduar për këtë fshat, por si projekt ende nuk është finalizuar sepse kanalizimit nuk i është ndërtuar gropa septike
Ndërtimin e një punkti të shëndetësisë dhe asfaltimin e rrugës në fshatin Bytyç	Asfalti është kryer, punkti shëndetësor nuk ka nisur
Kanalizimin, ujësjellësin dhe ndërtimin e shkollës në fshatin Llapushnik	Këto projekte janë kryer
Asfaltimin e rrugës Llapushnik - Krajkovë.	Është kryer pjesërisht
Ndërtimin e ujësjellësit, dhe ndërtimin e një shkolle në fshatin Baice.	Shkolla nuk ka nisur, ndërsa projektet e tjera, disa janë kryer e disa të tjera janë në vazhden e punimeve

## 11. Burimet:

1. Komuna e Drenasit. Buxheti i vitit 2010. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/glllogoc/getattachment/adaf4c38-f7fe-4062-bb0d-efbc2b247f51/Raport-i-buxhetit-te-komunes-per-vitin-2010.aspx>
2. Komuna e Drenasit. Buxheti i viti 2011
3. Komuna e Drenasit. Raporti i Punës së Komunës së Drenasit për vitin 2011. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/glllogoc/getattachment/40c48ca2-6a97-4cd5-bf47-a1c1d6e6aa5e/RAPORTI-VJETOR-I-PUNES-PER-VITIN-2011.aspx>
4. Komuna e Drenasit. Raporti i buxhetit për nëntë mujorin e 2012. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/glllogoc/getattachment/8001475e-7da6-4824-8ef9-3a2336813e6f/Raport-financiar-per-perioden-Janar-Shtator-2012.aspx>
5. Tabelat e Buxhetit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011. <http://mf.rks-gov.net/sql/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiqendrore.aspx>
6. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
7. Raportet vjetore 2010 -2011 të Koomisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - [http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCannual&PPRCMenu\\_OpenNode=90](http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCannual&PPRCMenu_OpenNode=90)
8. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Lipjanit. - [https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu\\_OpenNode=114](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114)
9. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për vitin 2011 për Komunën e Drenasit. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KDR\\_2011\\_Shqip\\_601539.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KDR_2011_Shqip_601539.pdf)
10. Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik. Njofimet e shpallura për Komunën e Drenasit.
11. Kuvendi i Kosovës. Ligji për ndarjen e kufijve administrativ. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L041\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L041_al.pdf)
12. Komuna e Drenasit. Lista e të punësuarve në administratën komunale 2012
13. Komuna e Drenasit. Lista e të punësuarve në sektorin e arsimit 2012
14. Komuna e Drenasit. Lista e të punësuarve në sektorin e shëndetësisë 2012